



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 135, Datë 07.07.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SËSHOQËRISË
“POWER ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1924/1 prot., datë 30.06.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “POWER ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1924 prot., datë 23.06.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaroi se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator të ERE-s si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, b, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmës (a).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2.5 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar informacionin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë gjatë 5 (pesë) viteve të ardhshme të licencës.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

gërma “b”: Shoqëria të dokumentojë se disponon vlerën e mbetur që i nevojitet për të garantuar të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

gërma “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE një plan 5-vjecar të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “POWER ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrît AHMETI